



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
SEKTORI EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 418 / Prot. 15

Patos, më 22 / 04 / 2024

MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKT VENDIM

Nr. 41, datë 22 / 04 / 2024

**PËR SHFUQIZIMIN E VKB-SË NR. 23, DATË 29.03.2024 PËR DHËNIEN E
NDIHMËS FINANCIARE NË RAST FATKEQËSIE TË SHKAKTUAR NGA
RËNIA E ZJARRIT NË BANESË DHE HUMBJEN E JETËS SË Z. SABRI
SERDARI NË FSHATIN VERBAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE ZHARRËZ.**

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" pika 3, neni 113 i ligjit nr. 44/2015 "Kodi procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", shkresës me nr. 389/1 prot., datë 11.04.2024 me lëndë "Kthim përgjigje" për verifikimin e ligjshmërisë së vendimit nr. 23 të Prefektit të qarkut Fier, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë:

1. Shfuqizimin e V.K.B-së nr. 23, datë 29.03.2024 "Për dhënie e ndihmës financiare në rast fatkeqësie të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë dhe humbjen e jetës së z. Sabri Serdari në fshatin Verbas, Njësia Administrative Zharrëz".

Anëtarët e Programit të mbrojtjes nga zjarri, shpëtimit dhe mbrojtjes civile.

Ermenita Mjci

Gazmira Plesati

Arben Shpërdheja

Alket Halimi

Vesjana Sanxhaku

Eljano Kumaraku

Juriste

Nurkë Hazizaj

Adresa: Lagja "Nallëtar". Rruga "Unaza", Patos



REPUBLIKA E SHqipërisë

BASHKIA PATOS

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
SEKTORI EMERGJENCAVE CIVILE**

Nr. 418/16 Prot.

Patos, më 29/03/2024

RELACION

**PËR SHFUQIZIMIN E VKB-SË NR. 23, DATË 29.03.2024 PËR DHËNIEN E
NDIHMËS FINANCIARE NË RAST FATKEQËSIE TË SHKAKTUAR NGA
RËNIA E ZJARRIT NË BANESË DHE HUMBJEN E JETËS SË Z. SABRI
SERDARI NË FSHATIN VERBAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE ZHARRËZ.**

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Këshilli i Bashkisë bazuar në projektvendimin me nr. 27, datë 13.03.2024, me nr. 418/1 prot., datë 13/03/2024, relacionin me nr. 418/2 prot., datë 13.03.2024, "Për dhënie e ndihmës financiare në rast fatkeqësie të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë dhe humbjen e jetës së z. Sabri Serdari në fshatin Verbas, Njësia Administrative Zharrëz". ka marrë Vendimin nr. 23, datë 29.03.2024, me nr. 418/3 prot., datë 26.07.2022. Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 389/1 prot., datë 11.04.2024, "Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë bazuar në nenin 8, shkronjat "a", "j" të ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" për vendimin e Këshillit Bashkiak Patos me nr. 23, datë 29.03.2024", shprehet se:

Ky vendim i miratuar nga Këshilli Bashkiak Patos, ju kthehet si i pa bazuar në V.K.M-në nr. 414, dt. 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile".

Bazuar në pikën 3, neni 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", "Anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë":

Kërkojmë nga ana e Këshillit Bashkiak shfuqizimin e vendimit nr. 23, datë 29.03.2024.

Anëtarët e Programit të mbrojtjes nga zjarri, shpëtimit dhe mbrojtjes civile.

Ermenita Mici

Gazmira Plesari

Arben Shpërdheja


Alket Halimi

Vesjana Sanxhaku

Eljano Kumaraku

**KRYETARI
Fation Duro**

Adresa: Lagja "Nafëtari", Rruga "Unaza", Patos



REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI I QARKUT FIER
SEKTORI JURIDIK

Nr. 389 Prot.

Fier, më 11.04.2024

Lënda: Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve Nr. 23, dhe Nr. 24, të Këshillit të Bashkisë Patos, të miratuara në mbledhjen e datës 29.03.2024.

BASHKISË PATOS
KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Patos

Në përgjigje të shkresës Tuaj me Nr. 760/6 prot. datë 04.04.2024, protokolluar pranë e Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 389 prot. datë 08.04.2024, bazuar në Ligjin Nr.107/2016 "Për prefektin e qarkut" neni 8, shkronjat "a", "j" neni 16, si dhe në Ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3.1 pika 2, shqyrtuam ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit të Bashkisë Patos, të miratuara në mbledhjen e datës 29.03.2024, shoqëruar me dokumentacionin plotësues të vendimeve dhe procesverbalet e zbardhura të mbledhjes, sipas kësaj si më poshtë:

Për vendimin e Këshillit të Bashkisë Patos (Nr. 23, datë 29.03.2024) "Për dhënien e ndihmës financiare në rast fatkeqësie të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë dhe humbjen e jetës së z. Sabri N. edari në ishutin Verbas. Njësia Administrative e Zharrës", i shoqëruar nga projektvendimi Nr. 23 datë 29.03.2024, protokolluar me Nr. 418/1 prot datë 13.03.2024, relacioni Nr. 418/2 prot. datë 13.03.2024, ju sqarojmë si më poshtë.

Këshilli i Bashkisë Patos me vendimin Nr. 23, datë 29.03.2024 (të shprehur) ka miratuar dhënien e një ndihme financiare prej 500 000 lekë nga fondi i kushtëzuar për familjen e Z. Sabri N. edari, pasi ky i fundi i pasoi e zjarrit që ra në banesën ku jetonte këtu për jetë. Ky vendim i miratuar nga Këshilli i Bashkisë Patos, bazuar në nenin 3.1 pika 2, të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", nuk përbën akt me karakter administrativ. Në këtë rast Prefekti i Qarkut Fier detyrimi për të veaktuar ligjshmërinë e kësaj nga të cilat shkronja "j" të Ligjit Nr.107/2016 "Për prefektin e qarkut", në të cilin parashikohet se prefekti i Qarkut ushtron edhe detyra të tjera të ngarkuara me akte ligjore ose nënligjore. Konkretisht kjo detyrë parashikohet në pikën 6, të VKM-së Nr. 414, datë 8.7.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndalimit dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile".

Vendimi për dhënien e kësaj ndihme financiare për sa i përket përdorimit të fondit është bazuar në VKM Nr. 414, datë 8.7.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndalimit dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile". Konkretisht në pikën 3.1 shkronja "a", e cila parashikon se: "60 (gjashtëdhjetë) %– 100 (njëqind) % e fondit të dedikuar për mbrojtjen civile mund të përdoret për:

- a) akordimin e ndihmës financiare për familjet, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera, sipas kriterëve specifike të përcaktuara në aktet nënligjore që rregullojnë ligjin nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", neni 41".

Ky nen parashikon dhënie e ndihmës financiare familjeve, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera.

Ligji Nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" neni 3 jep përkufizimin e termave "fatkeqësi natyrore" dhe "fatkeqësi të tjera"

"Fatkeqësi natyrore" janë fatkeqësitë që shkaktohen nga dukuri natyrore ekstreme, që lidhen me tërmetet, përmytjet dhe vërshimet e ujit, temperaturat ekstreme dhe të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta në tokë dhe në det, zjarret masive në pyje, sëmundjet infektive masive dhe dukuri të tjera që ndikojnë në jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

"Fatkeqësi të tjera" janë aksidentet teknologjike, rrugore, hekurudhore, detare, ajrore, si dhe zjarret, rrëzimet e digave, aksidentet bërthamore ekologjike ose industriale dhe aksidente të tjera të shkaktuara nga veprimi njerëzor, lufta ose gjendja emergjente, përdorimi i armëve dhëmjetëve të shkaqërimit në masë, sulmet terroriste, si dhe lloje të tjera të dhunës masive.

Theksojmë se roli i Prefektit në këtë rast është të verifikojë ligjshmërinë e përdorimit të fondeve të kushtëzuara në përputhje me VKM Nr. 414, datë 8.7.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" dhe jo të drejtën e familjarëve të të ndjerit Z. Sabri Serdari, për të kërkuar ndihmë nga Bashkia Patos për fatkeqësinë që iu ka ndodhur apo të drejtën e Bashkisë Patos për të akorduar ndihmë financiare për familjet që janë prekur nga fatkeqësi.

Në relacionin bashkëlidhur vendimit nuk sqarohet arsyeja se pse vendimi është i mbështetur në VKM Nr. 414, datë 8.7.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", konkretisht në pikën 3.1 shkronja "a". Cilat kritere plotësohen në këtë rast që të mund të përdoret fondi i kushtëzuar?

Për sa i përket mbështetjes së bazës ligjore të vendimit në VKM Nr. 414, datë 8.7.2021 ju sqarojmë se:

Mbështetja e vendimit në VKM Nr. 414, datë 8.7.2021 për sa i përket përdorimit të fondeve të kushtëzuara nuk qëndron pasi shkronja "a" e pikës 3.1 e vë theksin tek akordimi i ndihmës financiare për familjet banesat e të cilëve janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera. VKM-ja Nr. 414, datë 8.07.2021, në asnjë pikë të saj nuk përcakton që bashkia mund të përdorë fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për të akorduar ndihmë financiare për familjet, familjarët e të cilëve kanë humbur jetën për shkak të rënies së zjarrit në banesë dhe kjo është e kuptueshme pasi bashkia nuk mund të mbështetet tek ardhja e këtij fondi për të ndihmuar familjarët në të tilla fatkeqësi por duhet të rregojë me fondet e veta.

Akordimi i ndihmës financiare që jepet sipas pikës 3.1 shkronja "a" duhet të bëhet sipas kritereve specifike të përcaktuara në aktet nenligjore që rregullojnë ligjin nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", neni 41". Ky nen gjithashtu nuk përcakton në asnjë pikë të tij që bashkitë të mund të akordojnë ndihmë financiare nga fondi i kushtëzuar për familjet, familjarët e të cilëve kanë humbur jetën në një banesë që përfshihet nga një fatkeqësi.

Bashkia Patos duhet të ketë parasysh se kriteret e përgjithshme të ndarjes së fondit të kushtëzuar, të akorduar nga buxheti qendror dhe dokumentet orientuese për përdorimin e këtij fondi, duhet të bazohen në:

- a) strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë;
- b) vlerësimin vendor të riskut;

te emergjencave civile;

te zhvillimit urban.

me sipër Vendimi Nr. 23, datë 29.03.2024 "Për dhënien e ndihmës financiare në rast kushtëzuar të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë dhe humbjen e jetës së Z. Sabri Serdari në fshatin Verbas, Njësia Administrative Zharrës", me fonde nga fondi i kushtëzuar ju kthehet si i pa bazuar në VKM-në Nr. 414, datë 8.07.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile".

Bashkia Patos për të akorduar ndihmë financiare për familjen e të ndjerit Z.Sabri Serdari, mund të përdori fondet e veta.

Vendimi i Këshillit të Bashkisë Patos Nr. 24, datë 29.03.2024 "Mbi miratimin e tavanëve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027", shoqëruar nga projektvendimi Nr. 23, datë 13.03.2024 i protokolluar me Nr. 725/3 Prot. datë 13.03.2024, relacioni Nr. 729/4 prot. datë 13.03.2024, është në përputhje me ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), neni 8 pika 2, neni 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", neni 41, pika 1, ligjin Nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 34, pika 6, ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" (i ndryshuar) neni 3, pika 26, neni 4, neni 26, Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 23, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore" si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr. 3, datë 28.02.2024. "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027".

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

NË MUNGESË
SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Arben Vello

